logo Image not found or type unknown

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: UJË I PASTËR DHE KANALIZIME

Sigurimi i furnizimit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë.

Target: 6.5

6.5 Deri në vitin 2030, të zbatohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkufitar sipas rastitt.

Instrumentet ndërkombëtare	Nenet
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	Neni 14.2 h (h) Të gëzojë kushte të përshtatshme jetese, veçanërisht në lidhje me strehimin, kanalizimet, furnizimin me energji elektrike
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut	Neni 22 Secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë sigurimi social dhe t? drejta t? domosdoshme ekonomike, sociale e kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit t? tij, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti.
Konventa për të Drejtat e Fëmijës Konventa për të Drejtat e Fëmijës	24.2 c 24.2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura: (c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

Ligjet	Nenet

LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS	Neni 2 Me këtë ligj rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësorë, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre; përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmbytjet, vërshimet, thatësitë, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohet ose shkarkohen ujërat.
LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS	Neni 6.1.5 1.5. Parimin e integrimit - që do të thotë se gjatë administrimit me ujëra, duhet të parashikohet mundësia e lidhjes mes veti të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor, raportet mes tyre dhe me ekosistemin e varur nga ujërat dhe mediume të tjera në mjedis si dhe politikat e sektorëve tjerë siç janë bujqësia dhe industria të cilat duhet të marrin në konsiderim çështjet e administrimit të ujërave;